



Titulli i trajnimit: **Vlerësimi i Pasurive të Paluajtshme**

Qëllimi i trajnimit:

- Përgatitja e kandidatëve për licencim për vlerësimin e pronave të paluajtshme;
- Ofrimi i njohurive për metodat e vlerësimit dhe rastet kur duhet të përdoren ato;
- Ofrimi i njohurive për përgatitjen e raporteve të vlerësimit;
- Aplikimi praktik i njohurive përmes shembujve të vlerësimit;
- Aplikimi i dispozitave ligjore dhe rregullative, si dhe procedurave të kërkuara në përputhje me rregullat, kriteret dhe specifikat e Republikës së Kosovës
- Menaxhimi i plotë i procesit të vlerësimit nga fillimi deri në dorëzimin e raportit final të vlerësimit.

Modulet e trajnimit

Trajnimi përmban katër module me gjithësej 120 orë trajnimi. Katër modulet janë si vijon: Bazat e vlerësimit, Infrastrukturën ligjore, Metodologjitë e vlerësimit dhe Vlerësimi i tokave, urbanistika gjeodezia dhe kadastri. Gjithashtu, gjatë këtij trajnimit do të jepen udhëzime specifike për përgatitjen e raportit të vlerësimit.

Kushtet e pjesëmarrjes

Trajnimi është i dizajnuar për kandidatë të cilët plotësojnë kërkesat e parapara në Kriteret neni 19 në Plotësim/Ndryshim i Rregullorës së Bordit Mbikëqyrës për Licencimin e Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të paluajtshme:

- a) Duhet të jetë person fizik dhe banor i Republikës së Kosovës;
- b) Duhet të ketë Diplomë Universitare në njërin nga fakultetet në vijim: Ndërtimtari, Gjeodezi, Arkitekturë, Ekonomi, Bujqësi dhe Pylltari, drejtimi Matematikë dhe Juridik;
- c) Nuk duhet të ketë çështje të hapura gjyqësore për çështje penale apo të fushës për të cilën dëshiron të licencohet (Dëshmi të organeve kompetente).

Duhet të plotësohet dhe sillet fizikisht Aplikacioni, Deklarata e Etikës, Vetdeklarimi dhe Lista e Dokumentacionit për Licencim të Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme si në vijim.

Këto dokumente duhet të dorëzohen në pliko (zarf) të mbyllur në zyrën e sekretarisë së bordit e cila gjendet ne objektin e Odës Ekonomike të Kosovës kati i I-rë

Për arsye të interesimit të lartë për pjesëmarrje në këtë trajnim dhe mundësive për pranimin e një numri relativisht të vogël të pjesëmarrësve, maksimum 45 kandidatë, do të organizohet provimi pranues me pyetje logjike dhe pyetje bazike rreth vlerësimit të pronave të paluajtshme.

Kohëzgjatja

Trajnimi zgjatë gjithsej 120 orë ligjërimit dhe kandidatët iu nënshtrohen 4 provimeve për katër modulet. Prezantimet e ligjëruesve mund të sigurohen në formë elektronike apo të printuar, ndërsa librat dhe materialet tjera shtesë duhet të sigurohen nga vet kandidatët.

Organizuesi dhe Vendi

Bordi Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme në bashkëpunim me Odën Ekonomike e Kosovës, në kuadër të objektit të Odës Ekonomike të Kosovës.

Çmimi: Çmimi total i trajnimit është **725 Euro**

Me rastin e aplikimit duhet të dorëzohet fletëpagesa në vlerë prej **25 Euro** për organizimin e Provimit Pranues (kjo vlerë duhet të bëhet në nr i xhirollogarisë: **BKT 1901217736031640** - Emri, Mbiemri - Pagesë për aplikim dhe nënshtrim të provimit pranues)

Pagesa në vlerë prej **700 Euro**, bëhet para fillimit të ligjeratave. Në këtë vlerë është paraparë edhe organizimi i provimeve për herën e I-rë.

Afati i aplikimit nga data 24.01.2019 deri më datën 06.02.2019 në ora 16:00.